**STATUS**

SHOQERIA **"CAMI INTERNACIONAL'**SHPK

KREUI

Temelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

Neni 1:
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit.

Sot, me date 02.04.2018 ne, themeluesit, kemi krijuar nje' shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **" CAMI Internacional"** SH.P.K.
Themeluesi e shoqerise eshte z. Edmond Cami me adrese: Rruga Medar Shtylla nr. 722, Numer Ndertimi 43, Ap. 18. Kutia postare 1019, Njesia Bashkiake 5, Tirane si pjesemares me **100** % te kapitalit te subjektit.

Neni 2
Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem: Nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve te ndyshme si: kromit, bakrit, hekur nikelit etj.Tregtimin e materialeve industriale, ushqimore eksport-importi tyre, ne fushen e ndertimit, transportit rrugor, projektimit dhe zbatimit te projektit te pyjeve dhe kullotave, shfrytezimin, prodhimit, seleksionimi, perpunimi, ransporti dhe tregtimi i mineraleve te ndryshme si dhe nenproduktet e tyre, tregtimin dhe perdorimin civil te lendeve plasese per qellim nxjerrjen e mineraleve, sherbimin privat te ruajtjes fizike, tregtimin operimit dhe tregtimin e energjise elektrike.

Neni 3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje kohe te papercaktuar.

Neni 4
Selia

Selia e shoqerise do te jete ne adresen: Tirane, Rruga Medar Shtylla nr. 722, Numer Ndertimi 43, Ap. 18. Kutia postare 1019, Njesia Bashkiake 5.

Adresa per komunikim elektronik eshte **camimond@yahoo.com** .

KREU II

Kapitali

Neni 5 Kapitali
themeltar

Kapitali fillestar themeltar i shoqerise do te jete **100.000(Njeqindemije)leke, i perbere nga 1 kuote, i zoteruar nga ortaku i vetem i shoqerise Z.Edmond Qerim Cami**

Neni 6
Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalin themeltan te kontributeve ne para dhe te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute dhe sipas kerkeses se administratorit.
Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapital themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila mer vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimet ne statut.
Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitaleve qe perfaqesojne.

Neni 7
Tranferimi i kapitaleve

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a) kontributin ne kapitalin e shoqerise.
b) shitblerjes.
c) trashegimise.
d) dhurimit.
e) çdo menyre tjeter e parashiguar ne ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te tranferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk jane percaktuar ndryshe ne statut.
Pjese ta kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

KREU III
Organet vendimmarrese te shoqerise

Neni 8
Organi vendimarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuar me ligj.
Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
b) ndryshimet e statutit.
c) emerimin e shkarkimin e administratoreve.
ç) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.
d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne piken "c" e "d"te kesaj pike.
dh) mbikqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore e te raporteve te ecurise se veprimtarise.
e) miratimin e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
ë) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
h) miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.
Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjen e radhes me nje rend dite.

Neni 9
Menyra e thirrjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme.

Asamblese se pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes

elektronike.Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektonik duhe te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites, e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te mare vendime nese te gjithe ortaket jane dokort, per te marre vendime, panvarsisht parregullsise.

Neni 10
Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime ne marin pjese ortaket me te drejte vote, qe perfaqesojne me shume se 30 % te kuotave.
Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendise per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo mun te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e totalit te votive, jane te pranishem, votojne me shkrese, apo me mjete elektonike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permbledhur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve.

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si:
a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
b) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
c) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
ç) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne pikat "c" e "ç" te kesaj pike;
d) mbikqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore e te raporteve te ecurise se veprimtarise.
e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
f) miratimin e regullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Çdo ndryshim statute duhet te depozitohet ne QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12
Perjashtimi nga e drejta e votes

1) Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme mer vendim per:
   a) vleresimin e veprimtarise se tij.
   b) shuarjen e nje detyrimi ne ngarkim te tij.
   c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria.
   d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
2) Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13
Administrimi

1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizik si administrator te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte per regjistrimit

ne Qendren Kombetare te Biznesit.
2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administrator te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
3) Personi e meposhtem caktohen si administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asambleja se Pergjithshme.

**Te dhenat e indetifikimit**; Edmond Cami i datelindjes 15.08.1692 dhe ID te leternjoftimit G20815070S lindur ne Diber dhe banues ne Tirane me adrese vendbanimi:

Neni 14
Kompetencat e administratoreve

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te;
a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleje e pergjithshme;
b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
c) kujdesen per mbajtjen e rregullt e te sakte te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
e) pregadit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqisin keto dokumenta perpara asambl-ese se pergjithshme per miratim;
d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen dhe ekzistencen e veprimtarise;
dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
a) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare, dhe me realizimin e veprimtarive te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
ë) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilet kane nje vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuar.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para te regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane nje vlere me te larte se 5 per qind te te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ato e administrojne bashkerisht shoqerine.
Asambleja e pergjithshme mund te pushoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerise rregulloren sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15
Pergjegjesit e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise dhe te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.
Pasojat e mareveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit ose ortakut qe ka bere marreveshjen per ta perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.
Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", administratori detyrohet:
1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuar ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interes me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat e percaktuar ne ligj dhe ne statut vetem per qellime te percaktuara ne keto dispzita;

c) te vleresoje me pergjegjshmeri çeshtjet, per te cilat merret vendim;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2. a) Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosve-prim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mire-besim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t`i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryeja e shkeljes, si dhe t`i kaloje çdo fitim personal qe ato dhe persona te lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori, ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ato pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" kryen veprimet e meposhtme;

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividente;

c) u shperndan aktivet e shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te zhvilloje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi;

Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket, individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire dhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e padise se administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## KREU IV
## Viti financiar-ekspertet

### Neni 16
### Viti financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimin te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### Neni 17
### Ekspertet

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ato ne lidhje ato ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pregatit raportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit e bilancit finan-

ciar vjetor si dhe per ate te kontrolleve periodike te ushtruara, te cila eshte i detyruar ti paraqese dhe ti dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar dhe miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## KREU V
## Prishja - riorganizimi i shoqerise

### Neni 18
### Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe:

a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;

b) me vendim te asamblese se ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";

d) me vendim gjykate.

Ne kete rast ortaket marin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likujdatore dhe shenuar ne çdo document te nxjere emrin e likujdatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese me perjashtim te rasteve kur ka nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit te emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marin nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i autorizuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te mbledhjes te asamblese te pergjithshme te ortakeve, pe perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen e IX te ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 20

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk shkruhet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", kodi civil dhe çfaredo ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmareveshje qe mund te lind ndermjet shoqerise dhe te treteve, do te jete kopetente gjykata shqiptare.

***O R T A K E T***

***E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR***

***"CAMI Internacional "Shpk***

**Edmond CAMI**